



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria –Vlada-Government*

*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit*  
*Ministarstvo obrazovanja, nauke, tehnologije i inovacije*  
*Ministry of Education, Science, Technology and Innovation*



INSTITUTI  
PEDAGOGJIK  
I KOSOVËS

INSTITUTI PEDAGOGJIK I KOSOVËS

## RAPORTI I KOMISIONIT PROFESIONAL-SHKENCOR PËR ZBATIMIN E PROCEDURËS SË ZGJEDHJES SË HULUMTUESIT TË PAVARUR NË INSTITUTIN PEDAGOGJIK TË KOSOVËS

Në bazë të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtarinë kërkimore-shkencore (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2003), neni 48 të Statutit të Institutit Pedagogjik të Kosovës në Prishtinë, Rregullores nr. 55/24 të datës 12.09.2024 për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve në Institutin Pedagogjik të Kosovës, Ligjit të punës numër 03/L212, vendimit nr.111/24 të datës 26.12.2024, të Këshillit Shkencor i Institutit, është shpallur konkursi për hulumtues të pavarur.

### VLERËSIMI PROFESIONAL DHE SHKENCOR

Detyra e komisionit është të shqyrtojë dokumentacionin dhe të hartojë raportin profesional. Më hartimin e raportit përfundon puna dhe përgjegjësia e komisionit. Komisioni për zbatimin e procedurës së zgjedhjes së hulumtuesit të pavarur për edukim parashkollor dhe parafillor, i emëruar me 28.01.2025, në mbledhjen e Këshillit Shkencor të Institutit Pedagogjik të Kosovës, në përbërje: Prof. Dr. Tringa Dedi (kryetare), Prof. Ass. Dr. Rozafa Ferizi Shala, (anëtare), Prof. Dr. Safete Shala (anëtare)

Komisioni, pasi e ka shqyrtuar me kujdes dokumentacionin e kandidatës të paraqitur në konkurs, i paraqet Këshillit Shkencor të Institutit Pedagogjik të Kosovës vlerësimin profesional-shkencor.

Duke u mbështetur në dokumentacionin dhe dosjen e dorëzuar nga kandidatja, komisioni vërteton se në konkursin e shpallur më datë 08.01.2025, në gazetën „Epoka e Re” dhe në faqen zyrtare të Institutit Pedagogjik të Kosovës, për pozitën e hulumtuesit të pavarur për edukim parashkollor dhe parafillor, të Institutit Pedagogjik të Kosovës, ka konkurruar vetëm një (1) kandidate, Mevlude Aliu Gashi, nr. i protokollit 02/25.

Komisioni, pasi e verifikoi dokumentacionin e dorëzuar nga kandidatja, ka konstatuar se kandidatja i plotëson kushtet formale juridike për t'iu nënshtruar procedurave të përzgjedhjes për hulumtues të pavarur. Komisioni me kujdes e ka shqyrtuar dosjen e kandidatës dhe, në bazë të kriterëve të shpallura në konkurs, thirrjen shkencore, përvojën e punës, të arriturat profesionale

shkencore, projektet për zhvillimin e punës profesionale-shkencore, komisioni i ka paraqitur të dhënat biografike dhe bibliografike për kandidaten që ka aplikuar, sipas datës dhe nr. të protokollit:

Bazuar në dispozitat e Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore, statutit të Institutit Pedagogjik, si dhe rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve në Institutin Pedagogjik të Kosovës, procedura vlerësuese për zgjedhje/rizgjedhje mbështetet në kriteret që dalin nga aktivitetet si në vijim:

- Dëshminë për regjistrim në studimet e doktoratës në programet relevante me pozitën e shpallur dhe fushëveprimtarinë e Institutit Pedagogjik të Kosovës;
- Të ketë punime të publikuara në revista shkencore të indeksuara, të njohura sipas rregulloreve në fuqi;
- Të ketë punime të publikuara në revistën “Kërkime Pedagogjike”;
- Të ketë marrë pjesë në aktivitetet shkencore brenda dhe jashtë vendit.
- Të ketë marrë pjesë në mënyrë aktive në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare nga fusha përkatëse;
- Të ketë përvojë të dëshmuar për aktivitetet shkencore e profesionale nga fusha e kërkuar me konkurs.

**Ma.sc. Mevlude Aliu Gashi (PhDc)**, u lind me 01.03.1076, në fshatin Likoc, komuna Skënderaj. Studimet themelore i mbaroi në Universitetin e Prishtinës, në Fakultetin Filozofik- Dega Pedagogji e Përgjithshme dhe mori titullin Profesor i Pedagogjisë, në vitin 2002. Po ashtu, studimet master i ka mbaruar në Universitetin e Prishtinës, në Fakultetin e Filozofik, Departamenti Pedagogji dhe mori titullin Master i Pedagogjisë në programin Master Shkencor, në vitin 2018. Ka regjistruar studimet e Doktoratës në Universitetin "Shën Klimenti i Ohrit" në Fakultetin e Pedagogjisë - programi studimor Shkencat e Edukimit, në Manastir, Maqedoni e Veriut, në vitin 2023.

Kandidatja Mevlude Aliu Gashi, ka ofruar dëshmi për përvojën e saj 17-vjeçare (që nga viti 2007) në Institutin Pedagogjik të Kosovës, përvojën në hulumtime, analiza, trajnime dhe forma të tjera të zhvillimit profesional të mësimdhënësve. Ndërsa, para vitit 2007, kandidatja ka punuar si mësimdhënëse dhe edukatore.

Lidhur me përvojën kërkimore-shkencore, kandidatja ka ofruar dëshmi për: 12 publikime të veçanta, autore e vetme dhe bashkautore, gjithashtu, ka ofruar dëshmi për 1 punim në revistën e indeksuar në Scopus, 11 publikime në revista vendore e ndërkombëtare (3 punime të publikuara në revista ndërkombëtare, 8 punime në revistën „Kërkime Pedagogjike”), 3 kumtesa dhe prezantime në konferenca shkencore ndërkombëtare, 8 prezantime në konferenca vendore dhe 22 kontribute tjera shkencore dhe profesionale (trajnime, koordinime, monitorime, etj).

**Tabela 1. Të dhënat për kandidatin**

Shënimet përmbledhëse për kandidatën e paraqitur për pozitën Hulumtues i pavarur për edukim parashkollor dhe parafillor, në bazë të konkursit të datës 08.01.2025

1.	Emri dhe mbiemri	Biografia (CV)	Grada dhe thirrja shkencore	Moshë (datëlindja)	Përvoja e punës në IPK	Përvoja kërkimore - shkencore			Dëshmi se kandidati nuk është i dënuar
						Publikimet në revista shkencore	Kumtesat në konferenca ndërkombëtare	Botime të veçanta	
1	Mevlude Aliu Gashi	PO	<b>Master</b> Pedagogji e përgjithshme Doktoraturë (Në proces) - Shkencat e Edukimit	01.03.1976	17	12 punime	3 kumtesa	12	PO

Mbështetur në të dhënat e prezantuara nga kandidatja, e cila është paraqitur për pozitën e zgjedhjes hulumtuese e pavarur, duke iu referuar Statutit të Institutit Pedagogjik të Kosovës, komisioni për zbatimin e procedurës së përzgjedhjes, i emëruar më 28.01.2025, në mbledhjen e Këshillit Shkencor të Institutit Pedagogjik të Kosovës, në përbërje; Prof. Dr. Tringa Dedi (kryetare), Prof. Ass. Dr. Rozafa Ferizi Shala, (anëtare), Prof. Dr. Safete Shala (anëtare), ka përgatitur këtë raport për Këshillin Shkencor të Institutit.



Duke u mbështetur në rezultatet dhe të arriturat e punës profesionale dhe shkencore, përgatitjen adekuate për pozitën e kërkuar në konkurs, punimet shkencore të botuara në revistat shkencore relevante, pjesëmarrjen në aktivitete profesionale, konferenca shkencore brenda dhe jashtë vendit, projektet shkencore, kontributet shkencore, përvojën e punës, përvojën e dëshmuar në projektet profesionale-shkencore të kërkuara me konkurs, komisioni propozon që kandidatja **Mevlude Aliu Gashi** i plotëson kushtet e përgjithshme dhe kushtet e veçanta, të kërkuara në konkurs, për pozitën hulumtues i pavarur në Institutin Pedagogjik të Kosovës.

## PËRFUNDIM

Në bazë të Ligjit për Veprimtari Kërkimore-Shkencore, nr. 04/L-135, të datës 28.03.2013, si dhe Statutit të Institutit Pedagogjik të Kosovës, nr.01/B, nr. 1740, të datës 11.06.2024, përkatësisht 28/24, Rregullores nr. 55/24 për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve në Institutin Pedagogjik të Kosovës. të datës 12.09.2024, si dhe bazuar në të arriturat profesionale dhe shkencore, komisioni i propozon Këshillit Shkencor të Institutit Pedagogjik të Kosovës kandidaten **Mevludë Aliu Gashi**, e cila i plotëson kushtet për pozitën hulumtues i pavarur në Institutin Pedagogjik të Kosovës.

Prishtinë, 03.02.2025

**Komisioni profesional-shkencor për zbatimin e procedurës së zgjedhjes së hulumtueses së pavarur në IPK**

1. Prof. Dr. Tringa Dedi (kryetare), Instituti Pedagogjik i Kosovës 
2. Prof. Ass. Dr. Rozafa Ferizi Shala, (anëtare), Universiteti i Prishtinës 
3. Prof. Dr. Safete Shala (anëtare), Instituti Pedagogjik i Kosovës 